



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

V E N D I M

Nr. 07 Datë: 22.07.2021

“MBI MIRATIM MARREVESHJE DHE PËRDORIM FONDI NGA PROGRAMI 04760, TË PLANIFIKUAR PËR BASHKEFINANCIME ME PROJEKTE TE BE-SE , NË BUXHETIN E KQSH PËR VITIN 2021”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2021, pasi dëgjoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, **“Mbi miratim marreveshje dhe përdorim fondi nga programi 04760, të planifikuar për bashkefinancime me projekte të BE-se , në buxhetin e KQSH për vitin 2021”**, bazuar në nenin 9,77 të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015”Për Vetëqeverisjen vendore”, në , VKQShkoder nr. 16, datë 30.12.2020 “Për miratimin e Buxhetit të KQShkodër, për vitin 2021”, Kontratës nr.83380824, Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, ” *për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19*”, si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 “*për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...*”

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, , pas relatimit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **10 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

VENDOSI;

1. Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet kryetarëve të bashkive Pejë (Kosovë), Plave e Guci (Mali i Zi) dhe kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër (Shqipëri).
2. Miratimin e marrëveshjes mes të Këshillit të Qarkut Shkodër, Marimangat Pejës, partner Leader i projektit dhe CodePartners, partner i projektit për Shqipërinë dhe transferimin e shumës së planifikuar në Buxhetin e Projektit, partnerit për Shqipërinë, Code Partners.
3. Miratimin e përdorimit të fondit të planifikuar në Programin 04760, kap.1, Art.604 “Për bashkëfinancime me projekte të BE-së” për projektin “Përmirësimi i cilësisë dhe vizibilitetit të destinacionit Majat e Ballkanit, me standarde të larta orientuar për tregun e turizmit”, sipas pikës 2 të Vendimit.
4. Shuma e fondit, bashkefinancim me projektin e mësipërm, do të jetë 1000 euro, me kursin e datës së kryerjes së veprimit ose rreth 125,000 leke.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

RELACION

DREJTUAR: Këshillit të Qarkut Shkodër.

OBJEKTI: “MBI MIRATIM MARREVESHJE DHE PËRDORIM FONDI NGA PROGRAMI 04760, TË PLANIFIKUAR PËR BASHKEFINANCIME ME PROJEKTE TE BE-SE , NË BUXHETIN E KQSH PËR VITIN 2021”

Këshilli I qarkut Shkodër ka mbështetur ndër vite, zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në territorin e qarkut, si një nga shtyllat e rëndësishme të zhvillimit ekonomik.

Në strategjitë e zhvillimit, hartuar nga administrata e KQ një vend të rëndësishëm zënë projektet e turizmit, përfshirë turizmin e natyrës dhe atë të aventurës.

Një shëmbull i sukseshëm është dhe destinacioni “Majat e Ballkanit” (Peaks of the Balkans, PoB)

Destinacioni Majat e Ballkanit (Peaks of the Balkans, PoB) ka lindur dhe është zhvilluar si projekt në vitet 2010-2013 nëpërmjet një projekti të përbashkët ndërmjet Komunave Pejë në Kosovë, Komuna Plavë në Mal të Zi dhe Këshilli i Qarkut Shkodër në Shqipëri. Partner mbështetës ishin dhe ministratë e turizmit përkatëse të tre shteteve. Financimi i projektit është bërë nga GIZ, Organizata Gjermane për Zhvillim.

Ky destinacion në vitin 2013 fitoi çmimin e parë për kategorinë "Steewardship Destination" nga ETTC si "Turizmi për të ardhmen".

Që në 2013 ekziston një marrëveshje tre palëshe ndërmjet administratave të pushtetit local në tre shtetet, për mirëmbajtjen e shtegut në territor, mirëmbajtjen e sitit dhe marketingun.

Për një vazhdimësi të sukseshme të shtegut, i cili ka pasur shumë frekuentim nga turistë vendas dhe të huaj, NGO Marimangat e Pejës në Kosovë, Code Partners në Shkodër me mbështetjen e GIZ Kosovë ka propozuar një tjetër projekt modest.

Partner shumë të rëndësishëm si “pronar” të shtegut janë administratat e KQ Shkodër, Komuna Pejë, Komuna Pllavë, Komuna Guci.

REPUBLICA E KOSOVES
SYNYMI I PROJEKTTIT ESHTË: Forcimi i ofertave të Majave të Ballkanit si një burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe punësimit për komunitetin lokal, duke rritur cilësinë e ofertave, vizitat turistike dhe shpenzimet turistike në rajone, si dhe përfshirjen e familjeve rurale në shërbimet e lidhura me turizmin

Rezultatet e pritëshme:

1. Nënshkrimi i memorandum i mirëkuptimit ndërmjet kryetarëve të bashkive Pejë (Kosovë), Plave e Guci (Mali i Zi) dhe kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër (Shqipëri).
2. Pjesëmarrja e 20 deri në 30 palëve të interesuara nga rajoni gjatë trajnimit dy ditor për organizimin e menaxhimit të destinacionit të Gjurmëve të Majave të Ballkanit.
3. Shtegu prej 192 km në tre shtete në rajonin e Bjeshkëve të Namuna do të sigurojë infrastrukturën me standardet më të mira për turistët
4. Zyrat e informacionit turistik në Majat e Ballkanit do të pajisen me rafta për oferta turistike (gjithsej 20 rafta do të shpërndahen në 7 zyra turistike).
5. Zyrat e informacionit turistik dhe 33 bujtina përgjatë gjurmës së Majave të Ballkanit do të pajisen me rafta të informacionit të Sigurisë.
6. Ëeb site do të ridizenjohet me një cilësi shumë profesionale e cila do të ketë formatin Scroll daën dhe është e përshtatshme për celularët dhe përmbajtja e informacionit do të jetë më e strukturuar, duke krijuar mundësi më të lehta për qasje në informacion për turistët. GPS i shtegut do të instalohet gjithashtu ku turistët mund ta shkarkojnë dhe ta përdorin atë si një udhëzues sigurie.

Buxheti I parashikuar është 21000 euro, nga të cilat 18000 euro janë financim I GIZ Kosovë, 1000 euro Komuna Pejë, 1000 euro Këshilli I Qarkut Shkodër dhe 1000 euro Komuna Plave e Guci

Për një unifikim të ofertës në të gjithë shtëgun, në tre shtetet buxheti menaxhohet nga NGO Marimangat e Pejës, Kosovë.

Buxheti prej 1000 euro mbështetje nga Këshilli I Qarkut Shkodër do përdoret për paisjen me rafta për vendosjen e materialeve sensibilizuese dhe informuese në Shqipëri.

Bashkëngjitur gjeni projektin.

Gjergjano Alinuka
G

Hasrat Jajko
H